5- KARRIGE PEDAGOGU, RROTULLUESE ME KRAHE



Karriket rrotulluese të këna shpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Karrigia do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli prej material plastik me 5 rrota në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastik ngarkesë-mbajtës. Krahët mbështetës të karrikes të jenë plastikë dhe ngarkesë mbajtës. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

6- PODIUM

Përmasat(gjatesi x gjeresi x lartesi): 400 x 200 x 15 cm

Materiali i përdorur për strukturën e pedanës do jetë pllakë zdrukthi (me spesor jo me pak se 16 mm). Pjesa e brendshme e saj do te ndertohet me te njejtin material te cilat do te montohen ne menyre vertikale duke formuar disa fole. Pjesa e dukshme e kësaj strukture do vishet me parket laminat. Pedana do jetë e ndarë në 4 pjesë 100 x 200 x 15 cm, kjo për efekt transporti. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

7- TABELE SHKRIMI

Tabela e shkrimit duhet te jete me ngjyre jeshile e pershtatshme qe te shkruhet me shkumes. Veshja anesore e saj me profil alumini, dhe kendet e tabelës te jene me tapa plastike. Ne fundin e saj vendoset nje profil alumini i cili sherben per vendosjen e shkumesave dhe mbledhjen e pluhurit te shkumesit. Siperfaqja e saj duhet te jete prej llamarine e veshur me danafol i cili krijon fushe manjetike me pluhurin e shkumesin afer siperfaqes dhe nuk lejon perhapjen ne ambjetin perreth.



8- DOLLAP PËR KLASA

Përmasat (gjeresi x thellesi x lartesi): 90 x 40 x 220 cm

Skeleti dhe sergjenët do jenë prej materiali melamine me trashësi 25 mm. Kapaket jane me material melaminë me trashësi 1.8 cm. Bordet anësore të skeletit, sergjenëve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë tapa fundore kunder gervishtjes. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali melaminë, me trashësi jo më të vogël se 1.8 cm. Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjen. Pjesa e dollapit ne lartësinë mbi 72 cm nga toka do të jetë i ndarë vertikalisht në dy hapësira të barabarta dhe horizontalisht në katër hapësira të barabarta duke krijuar hapësira të tilla që të shërbejnë për mbajtjen e çantave të studentëve. Elementi ndarës i hapësirave do të jetë melaminë me trashësi 1.8 cm. Dorezat dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali te kromuar. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

9- Grilla Roller Blackout



Materiali 100% polyester. Materiali e ka origjinën nga tregu European. Peshë 310g/m².

Blackout rate shkallë e ndërprerjes së dritës 100%.

Gjerësia 220cm (+-).

Lartësia sipas permasave të dritareve. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës. Ky lloj modeli është i paisur me mekanizmin dhe zinxhirin për ngritjen dhe uljen e tyre.

ZYRA E FINANCËS

1- Tavolinë pune me kënd

Tavolina duhet të jetë me material laminant me bordure të plastifikuar me trashësi 25 mm. Ajo do të ketë një strukturë të përbërë nga dy pjesë. Pjesa kryesore, me përmasa 160x80x 75 cm H, është e ndërtuar me panele anësorë të lidhura midis tyre në vertikalisht nga një panel lidhës, të cilat mbajnë edhe peshën e mobiljes. Pjesa e këndit, është me përmasa 160x50x65 cm H e cila do të përbëhet nga një bllok sirtarësh, 1 kapak dhe hapqësira për të vendosur njësinë qendrore të kompjuterit, me material laminant 18 mm me bordura të pastifikuara. Syprina do të ketë një të çarë rrethore, të mbuluar me aksesori përkatës, me diametër 5 cm për kalimin e kabllave të kompjuterit. Takimi në tokë me distanciatorë plastikë kundër lagështirës.

2- Tavolinë pune specialisti

Tavolina duhet të jetë me material laminant me bordure të plastifikuar me trashësi 25 mm. Dimensionet (160 x 70 x 75 h) cm. Ajo do të ketë një strukturë të përbërë nga dy panele anësorë me përmasa 70x75x2.5 cm, të cilat mbajnë edhe peshën e mobiljes dhe janë të lidhura nga një panel në pjesën balllore të saj me përmasa 153x45x1.8 cm. Syprina do të ketë një të çarë rrethore, të mbuluar me aksesori përkatës, me diametër 5 cm për kalimin e kabllave të kompjuterit. Takim në tokë me distanciatorë plastikë kundër lagështirës. Në përbërje të tavolinës do të jetë dhe një sirtariere me përmasat (gjerësi x thellesi x lartësi): 45 x 53 x 60 cm lartësi (se bashku me rrotat).

Struktura e sirtarierës do të jetë melaminë me trashësi 1.8 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Syprina dhe kapaket ballorë të sirtareve duhet të jenë prej material melamine me spesor. Bordet anësore, fiankeve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Sirtaria duhet të ketë 4 rrota sferike në fund dhe të mund të lëvizë nën tavolinë. Sirtari i parë nga lart duhet të jetë më i vogël dhe i përshtatur për të mbajtur sende të imëta, pjesa tjetër të ndahet në 3 sirtarë të barabartë. Sirtarët duhet të jenë të paisur me kyç që të realizojë mbyllje qendrore. Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarierës. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

3- Karrige rrotulluese per postet e punes



Karrige për tavolinën e punës do të jetë me përmasa respektive 63x36x100 cm. Kjo karrige prezantohet me shpinore te lartë, rritja e lartësisë bëhet nga një mekanizëm sinkron me piston i cili përmban gaz në vetvete për rregullatorin e lartësisë. Kjo karrige është e rrotullueshme nëpërmjet 5 rrotave me diametër 55 mm në material nejloni me vetëfrenim dhe të gomuar për dysheme me pllaka , me bazament dhe krahë të realizuara nga materiale plastik. Kjo karrige duhet të jetë me strukturë plastike në brendësi e mbushur me sfungjer e riveshur me material copë ngjyrë e zezë kundër njollave dhe kundër alergjisë ose me lekure te zeze.

4- Rafte per dosje dy kanatësh

Element gjysem i hapur per arkivim dokumentacioni jo me të vogël se (90x45xh200cm) me material laminant trashesi jo me të vogël se 25 mm, me bordure te plastifikuar per strukturen dhe sergjenat. Mobilja duhet të ketë dy kanata ne pjesen e poshtme me çelës, material melaminë 18 mm dhe 2 kanata xhami në pjesën e sipërme. I gjithë rafti duhet te jete i ndare vertikalish ne 5 hapsira nga të cilat dy të poshtmet do të jenë brenda hapsirës së mbyllur. Shpinorja e mobiljes duhet të jetë e veshur me material laminant, me trashësi jo më të vogël se 0.3 cm. Kembet duhet te jene metalike me lartesi jo me të vogël se 5 cm.

ADMINISTRATA

1- Tavolinë pune me kënd

Public Health Sector

Suprina e tavolines duhet të jetë me material mdf te laminuar 8 mm e punuar tamburato, me trashesi 5 cm. Pergjate te gjithë perimetrit te tavolines do te aplikohet një kornize dru lisi me gjerësi 5 cm, e dhe trashesi 2cm, e lyer. Kembet e tavolines do te jene me te njetin material si suprina e tavolines. Bashkimi I kembeve me suprinen e tavolines do te realizohet me kend 45 grade. Ajo do të ketë një strukturë të përbërë nga dy pjesë. Pjesa kryesore, me përmasa 200x80x75 cm H, është e ndërtuar me panele anësorë të lidhura midis tyre në vertikalitet nga një panel lidhës , të cilat mbajnë edhe peshën e mobiljes. Pjesa e këndit, është me përmasa 180x50x65 cm H, e cila do të përbëhet nga një bllok sirtarësh, 1 kapak dhe hapësira për të vendosur njësinë qendrore të kompjuterit, me material mdf te laminuar 8 mm e punuar tamburato, me trashesi 5 cm. Syprina do të ketë një të çarë rrethore, të mbuluar me aksesori përkatës, me diametër 5 cm për kalimin e kablllove të kompjuterit. Takimi në tokë me distanciatore plastikë kundër lagështirës.

2- Etazher i hapur

Etazher me element të hapur me përmasa jo me të vogël se (90x45xh200cm) me material mdf te laminuar 8 mm e punuar tamburato, me trashesi 5 cm. Pergjate te gjithë perimetrit te etazherit do te aplikohet një kornize dru lisi me gjerësi 5 cm, e dhe trashesi 2cm, e lyer. Bashkimi I

anesoreve me suprinen e etazherit do te realizohet me kend 45 grade. Mobilja duhet të jetë e ndarë vertikalish ne 5 hapsira . Shpinorja e mobiljes duhet të jetë e veshur me material laminant, me trashësi jo më të vogël se 0.3 cm. Këmbët duhet të jene metalike të veshura me plastikë me lartesi jo më të vogël se 5 cm.

3- Etazher gjysem i hapur

Element gjysem i hapur per arkivim dokumentacioni jo me të vogël se (90x45xh200cm) me material mdf te laminuar 8 mm e punuar tamburato, me trashesi 5 cm. Pergjate te gjithë perimetrit te etazherit do te aplikohet nje kornize dru lisi me gjeresi 5 cm, e dhe trashesi 2cm, e lyer. Bashkimi I anesoreve me suprinen e etazherit do te realizohet me kend 45 grade. Mobilja duhet të ketë dy kanata ne pjesen e poshteme me celës. I gjithë rafti duhet te jete i ndare vertikalish ne 5 hapsira nga të cilat dy të poshtëmet do të jenë brenda hapsirës së mbyllur. Shpinorja e mobiljes duhet të jetë e veshur me material laminant, me trashësi jo më të vogël se 0.3 cm. Kembet duhet te jene metalike me lartesi jo me të vogël se 5 cm.

3- Kënd gjysëmhark

Skelet druri, stil modern dhe tapiceri me lëkurë ekologjike. Mbushje me sfungjer cilesor. Modeli, seti, ngjyra, etj do te percaktohet nga Autoriteti Kontraktor ne momentin e lidhjes se kontrates.



FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

1- Karrige per auditor statike me suprinë tavoline



Karrige me strukture metalike, mbeshtetese dhe ndenjese statike dhe mbeshtetese per krahet, anes se djathte ti bashkelidhet nje suprine per te mundesuar mbajtjen e shenimeve nga studentet. Suprina te jete e rrotulluesheme rreth 2 akseve me aksesore cilesore. Mbeshtetsja dhe ndnjësja te jene te veshura me material amortizues, te mbuluara me material rezistent, antibakterial, i pedepertueshem nga uji dhe praktik per larje. Lartesia : shpinorja 90 cm dhe ulesja 45 cm. Karriget duhet te jene me aksesore per bashkimin e tyre perbri njera-tjetres.

2- Karrige për auditor statike të thjeshta



Karrige me strukture metalike, mbështetese dhe ndenjese statike. Mbështetësja dhe ndenjësja të jenë të veshura me material amortizues, të mbuluara me material rezistent, antibakterial, i pedepertueshem nga uji dhe praktik për larje. Lartësia : shpinorja 90 cm dhe ulësja 45 cm. Karriget duhet të jenë me aksesore për bashkimin e tyre përbri njëra-tjetres.

3- Karrige për auditor portative të thjeshta

Karrige me strukture metalike, portative. Mbështetësja dhe ndenjësja të jenë të veshura me material amortizues, të mbuluara me material rezistent, antibakterial, i pedepertueshem nga uji dhe praktik për larje. Lartësia : shpinorja 90 cm dhe ulësja 45 cm.

4- Tavolinë zyre (skrivani) 140*80*75 cm H



Material laminant me bordure të plastifikuar me trashësi 2.5 cm. Ajo do të ketë një strukturë të përbërë nga panele anësore me permasa 80*75*2.5, të cilat mbajnë peshën e mobiljes dhe janë të lidhura nga një panel në pjesën balllore. Suprian 140*80*2.5 do të ketë një të carë rrethore të mbuluar me aksesoren përkatëse, me diametër 5cm për kalimin e kabllave të kompjuterit. Takimi në tokë me distanciatorë plastik për lageshtirën.

5- Tavoline zyre (skrivani) 120*65*h75



Material laminant me bordure të plastifikuar me trashësi 2.5 cm. Ajo do të ketë një strukturë të përbërë nga panele anësore me permasa 65*75*2.5, të cilat mbajnë peshën e mobiljes dhe janë të lidhura nga një panel në pjesën balllore. Suprina 120*60*2.5 do të ketë një të carë rrethore të mbuluar me aksesoren përkatëse, me diametër 5cm për kalimin e kabllave të kompjuterit. Takimi në tokë me distanciatorë plastik për lageshtirën.

6- Komodine me 3 sirtare per tavolina



Komodine me permasa jo me te vogla se 42*55*55 cm me tre sirtare, te pajisur me doreza metalike te kromuara me celes. Materiali laminant me trashesi 2.5 cm me bordure te plastifikuar, te jete rezisrente nga goditjet dhe e pajisur me rrota.

7- Dollap gjysëm i hapur druri, me xham dhe çelës



Element 1/2 I hapur per arkivim dokumentash, jo me I vogel se 90*45*200 cm me material laminant trashesi 2.5 cm me bordure te plastifikuar. Mobilja duhet te kete 2 kanata ne pjesen e poshtme me celes dhe 2 kanata ne pjesen e sipërme me xham. I gjithë rafti duhet te jete I ndare vertikalisht ne 5 hapësira nga te cilat dy te poshtmet do te jene brenda hapësires se mbyllur. Shpinorja me laminant me trashesi jo me pak se 0.3 cm. Kembet metalike me lartesi jo me te vogel se 5 cm.



8-Tavolinë e vogël mesi



Tavolina do të jetë me material laminant , suprina me bordure te plastifikuar me trashesi 10 cm,po keshtu edhe kembet me trashesi 9cm dhe perimenter 36 cm.

9- Banak lavapjate salla specializanti (2*2.5)

Mobilje me kapake me material laminant me trashesi jo te te vogel se 1.6 cm me bordura te plastifikuara, pjesa e poshtme me 2 lavapjata inoksi me nga nje grope dhe vend per kullim, me permasa totale jo te me te vogel se 250*60*h85h, kembe 10 cm te regjistrueshme dhe mbuluara me fashete, suprina te jete material reziztues ndaj lageshtires me materisal laminant i plastifikuar me fashete, me trashesi 4.5-5 cm, pjesa e sipërme 250*30*h75.

10- Tavolina pune per unite dentare të thjeshta



Material me konstrukt mbajtes metalik dhe dhe laminant , me rrota,permasa totale 50x50xH90, permasa e mobiljes 50x50xH60 me sirtare cop suprina te jete material rezistues ndaj lageshtires laminant I plastifikuar.

11- Grila rroler



Grilë rollone e cila pengon filtrimin e plotë të dritës. Me material të plotë poliestre, me shtresë të dyfishtë, është te jete rezistente, të lahet me lehtësi, mund të shkurtohet apo përshtatet me dritaren , kornizës mbështetëse prej materiali alumini dhe copës së butë. Me sipërfaqen të lëmuar. , me aksesorëtt e përkates , te kete jetegjatesi ndaj diellit.

12- Frigorifer I vogël

Frigorifer I vogel me lartesi jo me te vogel se 50cm, gjeresi jo me vogel se 45 cm, thellesi jo me te vogel se 40 cm,me kapacitet jo me te vogel se 45 litra, material metal dhe plastik.

Public Health Sector

ADMINISTRATA-REKTORATI

1- Tavinë pune titullari

Përmasat e tavolinës do të jenë 210 *90*75 cm H. Material MDF me veshje plastike. Konturi anësor I suprinës do të jetë I rrumbullakosur. Ajo do te kete nje strukture te perbere nga panele anesore, me te njejtin material me suprinen, te cilat mbajne peshen e mobiljes dhe jane te lidhura nga nje panel ne pjesen ballore. Takimi ne toke me distanciature plastik per lageshtiren.

2- Tavinë kompjuteri per drejtuesin

Përmasat e tavolinës do të jenë 90 *60*75 cm H. Material MDF me veshje plastike. Konturi anësor I suprinës do të jetë I rrumbullakosur. Ajo do te kete nje strukture te perbere nga panele anesore, me te njejtin material me suprinen, te cilat mbajne peshen e mobiljes dhe jane te lidhura nga nje panel ne pjesen ballore. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Në pjesën e brendshme ka postin e tastierës të fiksuar me shina rrëshqitëse si dhe postin për mbajtjen e PC. Montimi dhe zmontimi

të jetë sa më i thjeshtë. Takimi ne toke me distanciatore plastik per lageshtiren.

3- Sirtarierë e lëvizshme me rrota

Përmasat(gjeresi x thellesi x lartesi): 45 x 53 x 60 cm lartësi (se bashku me rrotat)

Struktura e sirtarierës do jetë MDF me veshje plastike. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Syprina dhe kapaket ballore te sirtareve duhet te jene prej material MDF me veshje plastike. Bordet anësore, fiankeve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Sirtariera duhet të ketë 4 rrota sferike në fund dhe të mund të lëvizë nën tavolinë. Sirtari i pare nga lart duhet të jetë më i vogël dhe i përshtatur për të mbajtur sende të imëta, pjesa tjetër të ndahet në 3 serrarë të barabartë. Sirtarët duhet të jenë të paisur me kyç që të realizojë mbyllje qendrore. Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarierës. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

4- Tavoline mbledhjeje 160*90*75 cm H

Material MDF me veshje plastike. Ajo do te kete nje strukture te perbere nga panele anesore te cilat mbajne peshen e mobiljes dhe jane te lidhura nga nje panel ne pjesen ballore. Takimi ne toke me distanciatore plastik per lageshtiren.

5- Tavolinë mesi 60*60*45 cm H

Tavolina do të jetë me MDF me veshje plastike, suprina me MDF me veshje plastike bordure te plastifikuar.

6- Poltron pritje

Skelet druri, stil neoklasik me tapiceri ose lëkurë ekologjike. Mbushje me sfungjer cilësor.

7- Poltron statik per mbledhje

Me tapiceri prej lëkure ekologjike, me shpinore të lartë. Me një mekanizëm që lejon fiksimin e pozicioneve të ndryshme të përshtatshme në ulje. Shpinorja duhet të jetë e përshtatshme në pozicionet vertikalisht si dhe para e prapa. Duhet të ketë krahë anësore. Të ketë përshtatëse prej gazi për nivelimin e lartësisë. Thellësia e ulësës e përshtatshme për përdorues të rritur. Bazamenti duhet të jetë metalik, me 5 degëzime në formë ylli dhe me rrota sferike në ekstremet e tyre. Ngjyrat e tapicerisë janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

8- Kredencë

Kredencë, me dimensione (395 x 45x 90 cm h). Dollapi do te realizohet prej materiali MDF me veshje plastike. Raft i ekspozimit do të jetë i ndarë në dy pjesë vertikalisht. Në pjesën ballore kredenca do të përbëhet nga kapakë.

. Ngjyrat do te percaktohen ne kushtet e lidhjes se kontrates. Montimi te kryhet me aksesor metalik cilesore me shpim dhe bulloneri te fshehur sipas standarteve CE. Dorezat e kapakeve

duhet te jene metalike dhe cilesore. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

9- Dollap -Bibliotekë për zyrë

Dollap -Bibliotekë për zyrë, me dimensione (240 x 45x 240h). Dollapi do te realizohet prej materiali MDF me veshje plastikë. **Dollap -Bibliotekë për zyrë** do të jetë i ndarë në tre pjesë vertikalisht te barabarta, në pjesën e poshtme në lartësinë 160 cm nga toka, dy prej seksioneve në pjesën e brendshme do të ndahen në katër hapsira të barabarata dhe njëra do të shërbejë si garderobë.

Të gjithë kapakët do të jenë të mbyllura me çelës.

Montimi te kryhet me aksesori metalik cilesore me shpim dhe bulloneri te fshehur sipas standarteve CE. Dorezat e kapakeve duhet te jene metalike dhe cilesore. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës

10- Grilla Roller Blackout



Materiali 100% polyester. Materiali e ka origjinen nga tregu European. Pesha 310g/m2.

Blackout rate shkalla e nderprerjes se drites 100%.

Gjeresia 220cm (+-).

Lartesia sipas permasave te dritareve. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës. Ky lloj modeli eshte i paisur me mekanizmin dhe zinxhirin per ngritjen dhe uljen e tyre.

Public Health Sector

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall:		Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes
Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		



Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

LISTA E ARTIKUJVE

Nr	Emertimi i Artikullit	Njesia	Sasia
SALLA ISH BIBLIOTEKËS			
1	Karrige studenti me tavoletë	copë	80
2	Tavolinë pedagogu 140x70x75 cm	copë	1
3	Karrige pedagogu, rrotulluese me krahë	copë	1
4	Podium 400 x 200 x 15 cm	copë	1
5	Tabelë shkrimi	copë	1
6	Dollap për klasa 85*40*220 cm H	copë	1
7	Perde Roller blackout	m2	30
SALLA ANATOMISË (KATI D)			
1	F.V Karrige tip kinemaje	copë	156
2	F.V Tavolinë studenti 3- vendëshe	copë	24
3	F.V Tavolinë studenti 7 vendëshe	copë	12
4	Tavolinë pedagogu 140x70x75 cm	copë	1
5	Karrige pedagogu, rrotulluese me krahë	copë	1
6	Podium 300 x 200 x 15 cm	copë	1
7	Tabelë shkrimi	copë	2
8	Raft ekspozimi 180 x 45x 220h	cope	8

Dokumentat Standarde të Tenderit

9	Raft ekspozimi 240 x 45x 220h	copë	4
10	Perde Roller blackout	m2	26
	SALLA FARMACISË		
1	F.V Modul amfiteatri 4-vendëshe	copë	10
2	F.V Modul amfiteatri 3-vendëshe	copë	10
3	Tavolinë pedagogu 140x70x75 cm	copë	1
4	Karrige pedagogu, rrotulluese me krahë	copë	1
5	Podium 370 x 200 x 15 cm	copë	1
6	Tabelë shkrimi	copë	2
7	Dollap për klasa 120*40*220 cm H	copë	1
10	Perde Roller blackout	m2	22
	SALLA 6 KATËSHIT		
1	F.V Modul amfiteatri 3-vendëshe	copë	32
2	Tavolinë pedagogu 140x70x75 cm	copë	1
3	Karrige pedagogu, rrotulluese me krahë	copë	1
4	Podium 400 x 200 x 15 cm	copë	1
5	Tabelë shkrimi	copë	2
6	Dollap për klasa 90*40*220 cm H	copë	4
10	Perde Roller blackout	m2	26
	SALLA ANATOMISË (KATI II)		
1	F.V Modul amfiteatri 4-vendëshe	copë	15
2	F.V Modul amfiteatri 3-vendëshe	copë	30
3	F.V Modul amfiteatri 2-vendëshe	copë	15
4	Tavolinë pedagogu 140x70x75 cm	copë	1
5	Karrige pedagogu, rrotulluese me krahë	copë	1
6	Podium 400 x 200 x 15 cm	copë	1
7	Tabelë shkrimi	copë	2
8	Dollap për klasa 90*40*220 cm H	copë	3
10	Perde Roller blackout	m2	25
	ZYRA FINANCËS		
1	Tavolinë pune me kënd	copë	4
2	Tavolinë pune specialisti	copë	1
3	Karrige rrotulluese për postet e punës	copë	5
4	Rafte element gjysem i hapur	copë	6
	ZYRA ADMINISTRATES		
1	Tavolinë pune me kënd	copë	1

Dokumentat Standarde të Tenderit

2	Etazher I hapur	copë	1
3	Etazher gjysem I hapur	copë	1
4	Kend gjysem hark	copë	1
Fakulteti I mjekesise Dentare			
1	Karrige per auditor statike me suprinë tavoline	copë	20
2	Karrige për auditor statike të thjeshta	copë	50
3	Karrige për auditor portative të thjeshta	copë	20
4	Tavolinë zyre (skrivani) 140*80*75 cm H	copë	4
5	Tavolinë zyre (skrivani) 120*65*75 cm H	copë	1
6	Komodina me tre sirtarë	copë	4
7	Dollap gjysëm I hapur druri, me xham dhe çelës	copë	4
8	Tavolinë e vogël mesi	copë	1
9	Banak lavapjate salla specializanti (2*2.5)	ml	5
10	Tavolina pune per unite dentare të thjeshta	copë	5
11	Grila rroler	m2	200
12	Frigorifer I vogël	copë	1
ADMINISTRATA-REKTORATI			
1	Tavolinë titullari	copë	1
2	Tavolinë kompjuteri per drejtuesin	copë	1
3	Sirtarierë e lëvizshme me rrota	copë	1
4	Tavoline mbledhjeje 160*90*75 cm H	copë	1
5	Tavolinë mesi	copë	1
6	Poltron pritjeje	copë	2
7	Karrige mbledhjeje	copë	6
8	Kredencë	copë	1
9	Dollap -Bibliotekë për zyrë	copë	1
10	Perde Roller blackout	ml	17.3

Afatet e lëvrimit: 45 dite nga lidhja kontrates

Shtojca 13



[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e

kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

Shtojca 14



[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Dokumentat Standarde të Tenderit

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

Dokumentat Standarde të Tenderit

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Dokumentat Standarde të Tenderit

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME **Mallrat – Tender i Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.

- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që

kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intellektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikave, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së

mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës se shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.

- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
